



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .05.2024

**MBLEDHJA Nr. 17,
Datë 27.05.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 27.05.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 17 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 20.05.2024.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi miratimin e metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.
4. Mbi miratimin e procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë ALPEX sh.a. për miratimin e listës së tarifave për tregun brenda së njëjtës ditë.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**